



Duke u mbështetur në nenin 40.2 nën d), 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 47 dhe 48 të Statutit të Komunës së Klinës, Rregulloren Nr. 01-110-1653/2011 për punën e kuvendit dhe komiteteve, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më datë: 20.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratimin e Planit të Punës së Kuvendit dhe Kalendarit vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit dhe komiteteve për vitin 2023

1. Miratohet Plani e Punës së Kuvendit dhe Kalendarit vjetor të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit për vitin 2023.
2. Seancat e rregullta të Kuvendit të Komunës së Klinës do të mbahen javën e fundit të muajt. Seancat e rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa i paraprin Kuvendit dhjetë (10) ditë para seancave të Kuvendit të Komunës, Komiteti për Komunitete 15 ditë para Kuvendit, ndërsa komitetet tjera mbahen sipas kalendarit të propozuar. Komitetet Konsultative mbajnë së paku 6 takime në vit.
3. Kuvendi i Komunës së Klinës mbanë së paku dhjetë (10) seanca brenda vitit 2023, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Seancat mund të mbahen edhe me ndryshim të orarit në rast që kërkohen .
4. Mbledhjet plotësuese të Kuvendit dhe Komiteteve mund të mbahen në çdo kohë sipas nevojës.
5. Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë: Plani i Punës së Kuvendit, si dhe Kalendari i mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve të Kuvendit për vitin 2023.
6. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe pas publikimit në ueb faqen e komunës.
7. Me këtë vendim të njoftohen: MPL, Kryetari i Komunës, Drejtorët e drejtorive, Shërbimi për punë të Kuvendit, Zyra ligjore, zyra për informim dhe Arkivi i komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-42827/2022
Klinë, më 23.12 /2022



Kryesuesi,
Fadil Gashi